



A.nr.511/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.511/2026, të datës 07.05.2026, të parashtruar nga ankuesit: F.A, V.K, A.K, F.M, Sh.Z, E.I, V.K, Z.A, N.O, A.T, A.B, E.B, D.K, F.K, V.P, M.G, B.M, F.B, L.M, N.G, H.I, V.K, H.D, D.A, M.P, D.H-H, A.L-H, G.H, R.T, F.R, B.L, I.F, Q.T, F.K, N.H, A.Sh, A.G, G.P, K.A, G.K, T.A, M.G, M.Th-G, D.Z, M.A, Sh.E, S.K, F.M, M.B, F.G, M.A, Sh.R, L.I dhe A.H, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Shoqëria e Avokateve Klinaku&Associates, kundër organit të punësimit: Shërbimi Sprovues i Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 17.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.511/2026, e datës 07.05.2026, e parashtruar nga ankuesit: F.A, V.K, A.K, F.M, Sh.Z, V.K, Z.A, N.O, A.T, A.B, E.B, D.K, F.K, V.P, M.G, B.M, L.M, N.G, H.I, V.K, D.A, M.P, D.H-H, A.L-H, G.H, R.T, A.H, F.R, B.L, I.F, Q.T, F.K, A.Sh, A.G, G.P, K.A-K, G.K, T.A, M.G, M.Th-G, D.Z, F.M, M.B, F.G, M.A dhe L.I.

II. Mbetet në fuqi akti përgjigjja, me numër protokolli Nr.37 e datës 03.04.2026, e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës, lidhur me ankuesit si në paragrafin I të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.511/2026, të datës 07.05.2026, të parashtruar nga ankuesi E.I, F.B, H.D dhe N.H.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.511/2026, të datës 07.05.2026, të parashtruar nga ankuesit: M.A, Sh.E, S.K dhe Sh.R.

V. Ankuesit si në pikën IV të dispozitivit udhëzohen mbi të drejtën e inicimit të kontestit juridik-civil pranë gjykatës kompetente.

VI. Lënda e ankuesve si në paragrafin III të dispozitivit bartet për shqyrtim dhe vendosje pranë Komisionit për Ankesa në Shërbimin Sprovues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesit si në hyrje të këtij vendimi, të punësuar në Shërbimin Sprovues të Kosovës, më datë 07.05.2026, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin mbi të drejtën e kompensimit të përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ka hy në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokolli 2203/2026 të datës 07.05.2026, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 07.05.2026; Përgjigjen në kërkesë me numër protokolli Nr.37, të datës 03.04.2026; Autorizimet; Akt emërimet e ankuesve,

I. Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve: F.A, V.K, A.K, F.M, Sh.Z, V.K, Z.A, N.O, A.T, A.B, E.B, D.K, F.K, V.P, M.G, B.M, L.M, N.G, H.I, V.K, D.A, M.P, D.H-H, A.L-H, G.H, R.T, A.H, F.R, B.L, I.F, Q.T, F.K, A.Sh, A.G, G.P, K.A-K, G.K, T.A, M.G, M.Th-G, D.Z, F.M, M.B, F.G, M.A dhe L.I, ***është e pabazuar, sepse:***

Gjendja e çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesit si në pikën I kanë statusin e nëpunësit civilë. Rrjedhimisht, Ankuesi **F.A** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesja **V.K** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesja **A.K** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesja **F.M** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Asistente Administrative*; Ankuesi **Sh.Z**, sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesja **V.K** sipas Akt Emërimit të datës 30.06.2025, ushtron pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit Rajonal Mitrovicë*; Ankuesja **Z.A** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesi **N.O** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesi **A.T** sipas Akt Emërimit të datës 13.03.2017, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesja **A.B** sipas Akt emërimit të datës 15.05.2017, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesi **E.B** sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2015, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesi **D.K** sipas Akt Emërimit të datës 30.06.2025, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit Rajonal Gjakovë*; Ankuesja **F.K** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Asistente Administrative*; Ankuesja **V.P** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesja **M.G** sipas Akt Emërimit të datës 01.11.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtare për Arkiv 3*; Ankuesi **B.M** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesi **L.M** sipas Akt Emërimit të datës 17.05.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesi **N.G** sipas Akt Emërimit të datës 07.08.2025, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesi **H.I** sipas Akt Emërimit të datës 27.06.2025, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit Rajonal Prizren*; Ankuesi **V.K** sipas Akt Emërimit të datës 12.07.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Administrativ*; Ankuesi **D.A** sipas Akt Emërimit të datës 15.07.2025, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesja **M.P** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesja **D.H-H** sipas Akt Emërimit të datës 22.08.2025, ushtron pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit Rajonal Pejë*; Ankuesja **A.L-H** sipas Akt Emërimit të datës 03.11.2025, ushtron pozitën e punës *Zyrtare për Lirim me Kusht*; Ankuesja **G.H** sipas Akt Emërimit të datës 20.05.2014, ushtron pozitën e punës *Asistente Administrative*; Ankuesja **R.T** sipas

Akt Emërimit të datës 20.01.2026, ushtron pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit Rajonal Ferizaj*; Ankuesja **F.R** sipas Akt Emërimit të datës 02.02.2015, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesja **B.L** sipas Akt Emërimit të datës 02.04.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesi **I.F** sipas Akt Emërimit të datës 01.11.2025, ushtron pozitën e punës *Drejtor i Departamentit për Mbikëqyrjen e të liruarve me Kusht, Mbikëqyrje të Posaçme dhe Programe*; Ankuesja **Q.T** sipas Akt Emërimit të datës 24.05.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Administrative*; Ankuesja **F.K** sipas Akt Emërimit të datës 27.06.2025, ushtron pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e të liruarve me Kusht*; Ankuesi **A.Sh** sipas Akt Emërimit të datës 27.06.2025, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të Masave dhe Dënimeve Alternative për Persona të Mitur*; Ankuesi **A.G** sipas Akt Emërimit të datës 05.12.2025, ushtron pozitën e punës *Zyrtar për Buxhet dhe Financa*; Ankuesja **G.P** sipas Akt Emërimit të datës 01.09.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lart për të Mitur*; Ankuesja **K.A** sipas Akt Emërimit të datës 24.06.2025, ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lartë Ekzekutive*; Ankuesja **G.K** sipas Akt Emërimit të datës 15.03.2025, ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Mbikëqyrje të Posaçme*; Ankuesja **T.A** sipas Akt Emërimit të datës 15.12.2011, ushtron pozitën e punës *Arkiviste*; Ankuesja **M.G** sipas Akt Emërimit të datës 10.10.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Madhor*; Ankuesja **M.Th-G**, sipas Akt Emërimit të datës 02.06.2025, ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Burimeve Njerëzore*; Ankuesi **D.Z** sipas Akt Emërimit të datës 25.11.2025, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Administrimin e Shërbimeve të Përgjithshme*; Ankuesi **F.M** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtar Sprovues*; Ankuesja **M.B** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesja **F.G** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; Ankuesja **M.A** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*; dhe Ankuesja **L.I** sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2012, ushtron pozitën e punës *Zyrtare Sprovuese*;

Ankuesit më datë 25.02.2026 përmes përfaqësuesit të tyre më autorizim i janë drejtuar Shërbimit Sprovues të Kosovës më kërkesë që ankuesve t'ju bëhet kompensim në të holla i përvojës së punës 0.25 %, nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës në cilësinë e Zyrtaarit Kryesor Administrativ me datë 03.04.2026, është Përgjigjur në kërkesën me numër protokolli Nr.37, të datës 03.04.2026 , më të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesve lidhur me shtesën prej 0.5% për përvojën e punës me arsyetimin se në kapitullin IV pika 382 të aktgjykimit, Gjykata thekson se Ligji Nr.03/L-147 Për Pagat e Nëpunësve Civil është shfuqizuar pa ndonjë dispozitë alternative duke krijuar një zbrazëti ligjore që duhet të plotësohet nga Kuvendi. Andaj, derisa Kuvendi të miratoj ndryshimet e nevojshme ligjore, SHSP-së nuk mund të zbatojë një skemë të re pagese për përvojën e punës pa asnjë baze ligjore të qartë ligjore, dhe kështu në përputhje me aktgjykimin KO79/23 të datës 23 janar 2024 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe duke pasur parasysh mungesën e një baze ligjore për realizimin e shtesës prej 0.5% për përvojën e punës kërkesa duhet të refuzohet.

Pretendimet ankimore

Ankuesit në ankesën e parashtruar pretendojnë së me nxjerrjen e Aktgjykimit për rastin nr. KO79/23, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës ankuesve duhet tu njihet e drejta e kompensimit të shtesës prej 0.5% nga koha kur ka hyrë Ligji i Pagave në fuqi e në vazhdimësi. Kërkojnë që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të detyrohet Shërbimi Sprovues i Kosovës që ankuesve ti bëjë kompensimin e shtesës së përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ka hy në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe në vazhdimësi.

Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me pretendimin e ankuesve referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me të cilin është përcaktuar se:

“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, gjegjësisht në paragrafin II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 të këtij aktgjykimi ka sqaruar: 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë për qind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë

kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë vetëm mbi bazën e aktgjykimit kushtetues dhe rrjedhimisht, pretendimet ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk kanë mbështetje ligjore, kështu që Përgjigjja në kërkesë me numër protokolli Nr.37 e datës 03.04.2026 e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimi Sprovues të Kosovës, është i drejtë dhe i ligjshëm.

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në paragrafin I të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit : E.I, F.B, H.D dhe N.H, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton së ankuesi **E.I** sipas Marrëveshjes për Transferimin e Përhershëm të Nëpunësit civil të datës 12.06.2024, ushtron pozitën e punës *Teknik i mirëmbajtjes*; Ankuesi **F.B** sipas Akt Emërimit të datës 05.03.2013, ushtron pozitën e punës *Vozitës*; Ankuesi **H.D** sipas Akt Emërimit të datës 05.03.2013, ushtron pozitën e punës *Vozitës*; Ankuesi **A.H** sipas Akt Emërimit të datës 02.05.2014, ushtron pozitën e punës *Vozitës*; Ankuesi **N.H** sipas Akt Emërimit të datës 13.12.2013, ushtron pozitën e punës *Asistent Transporti*.

Kolegji i Këshillit lidhur me statusin e ankuesve si në pikën II, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 5, paragrafi 5, ku përcaktohet se: *5.Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike*". Rrjedhimisht, mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji konstaton së pozita vozitës, teknik i mirëmbajtjes dhe asistent transporti kategorizohet si pozitë e nëpunësit teknik dhe mbështetës, kështu që, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, atëherë, duke qenë së ankuesit si në pikën II nuk kanë statusin e nëpunësit civil, rrjedhë fakti së Këshill nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e tyre.

Në kuptim të udhëzimit të palës ankuese lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji vë theksin të neni 8 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 27 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se : *Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave, pra, zyrtarët publikë të kategorisë së shërbimit publik dhe të kategorisë administrative mbështetëse, në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënie e punës, fillimisht mund të përjashtojnë ankesë tek punëdhënësi i cili themelon një Komision të Ankesave në pajtim me kërkesat ligjore, e më pastaj, mund të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës ku shprehimisht thuhet se: **Neni 78 paragrafi 1** "... 1. I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas*

kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimi të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente...”

Marrë parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion apo kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve sipas pikës II dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se organi punëdhënës nuk ka vendosur lidhur me ankesën e ankuesve, atëherë, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve si në pikën II dhe të bartë lëndën të organi kompetent, në këtë rast të Komisioni i Ankesave në Shërbimin Sprovues të Kosovës.

II. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit M.A, Sh.E, S.K dhe Sh.R sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesit si në këtë pikë të arsytimit kanë humbur statusin e nëpunësit civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Andaj, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më të cilin përcaktohet së Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, atëherë, duke qenë së ankuesit më rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill nuk kanë statusin e nëpunësit aktiv civil, Kolegji konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve.

Si rrjedhojë, referuar pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë më raport juridiko-civil, kështu që, Kolegji lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), udhëzon palët ankuese që të drejtën e tij materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Procedurën Kontestimore.

KËSHILLË JURIDIKE: *Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.511/2026

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësueses së ankueseve Shoqërisë së Avokateve Klinaku&Associates;*
- *Shërbimit Sprovues të Kosovës: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Personelit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*